



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:213677

Datë: 27.02.2024

Numri i dokumentit: 05380574

KPPP.nr.1633/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë, kundër debitorit “PRINCE COFFEE HOUSE” Sh.P.K., me NUI: 811251595, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhit përbarimor P.nr.246/23 të datës 20.09.2023, të Përbaruesit Privat Eset Murati me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 15.02.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “PRINCE COFFEE HOUSE” Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhit Përbarimor P.nr.246/23 të datës 20.09.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Eset Murati, dhe i njejtë Urdhër MBETET NË FUQI.

**A r s y e t i m**

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë, me datë 20.09.2023, ka lëshuar Urdhrin Përbarimor P.nr.246/2023, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit përbarues Vendimit të Inspektoratit të Punës Nr.01/56-136/23 të datës 17.05.2023, me të cilin është obliguar debitori që në emër të masës ndëshkimore, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri, t’ia bëjë pagesën kreditorit në shumë prej 900.00 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar se urdhri për përbarim është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të LPP-së dhe atë nenin 27 par.1, duke shtuar se dokumenti përbarimor në bazë të së cilit është lëshuar urdhri nga Përbaruesi

Privat nuk i plotëson kushtet për përmbardim të cilat duhet t'i përmbajë dokumenti përmbardimor, të paraparë në nenin 24 par.3 dhe nenin 43 të LPP-së, pasi që propozimi bazohet në një vendim i cili nuk i është bashkangjitur propozimit për përmbardim, dhe si rrjedhojë vendimi i bashkangjitur nuk i përmban tiparet e parapara me ligj të dokumentit përmbardimor. Debitori po ashtu ka theksuar se ka paraqitur padi për konflikt administrativ, për shkak se Inspektorati i Punës-kreditori, me vendimet e veta ka shkelur në mënyrë flagrante të drejtat e debitorit dhe ia ka dëmtuar imazhin me pretendime të pabaza dhe të paqëndrueshme. I ka propozuar gjykatës që të aprovet si i themeltë prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përmbardimor i Përmbarduesit Privat, dhe të anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë procedurë dhe pasojat juridike.

Kreditori në përgjigje në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar thëniet në prapësimin e debitorit, duke theksuar se urdhri i Përmbarduesit Privat P.nr.246/2023 i datës 20.09.2023 është në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së. Ka shtuar se pretendimet në prapësim të debitorit lidhur me vendimin dhe ligjshmërinë e aktit administrativ, gjykata kompetente në konfliktin administrativ vendosë për këtë çështje. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe ta lë në fuqi urdhrin për përmbardim të lëshuar nga Përmbarduesi Privat.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, deklarimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbardimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar, andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbardues ka lejuar përmbardimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbardues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbardimin vetëm në bazë të dokumentit përmbardues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Me nenin 22 të LPP-së, në paragrafin 1 nënparagrafin 2 është përcaktuar se dokumente përmbarduese janë *“vendimi përmbardues i dhënë në procedurë administrative dhe ujdia...”*. Gjithashtu neni 23 paragrafi 2 i LPP-së ka përcaktuar se *“Vendim i organit administrativ, sipas*

*këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike...”, kurse neni 24 paragrafi 3 i LPP-së ka paraparë se “Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”.*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht Vendimin e Inspektoratit të Punës Nr.01/56-136/23 të datës 17.05.2023, në bazë të së cilit Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti se i njëjti, konform nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata gjeti se Vendimi Nr.01/56-136/23 i datës 17.05.2023, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: “*Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Nr.01/56-136/23 i datës 17.05.2023, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: “*Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri*”, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: “*Vërtetimin për përmbarueshmërinë e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë*”, ngase Vendimi Nr.01/56-136/23 i datës 17.05.2023, i nxjerrë nga Inspektorati i Punës, është dorëzuar në origjinal, si dhe është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm me datë 18.09.2023, e cila vërtetohet nga vula e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë.

Gjykata e vlerësoi pretendimin e debitorit se ka paraqitur padi për konflikt administrativ, mirëpo e gjeti si të pabazuar, ngase në bazë të nenit 22 par.1 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, përcaktohet se “*Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe*”, dhe konform kësaj dispozite ligjore vendimi i tillë i plotëson tiparet e përmbarueshmërisë, dhe si rrjedhojë nuk ka asnjë pengesë për zbatimin e përmbarimit.

Andaj, meqenëse në këtë çështje përmbare gjykata vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit përmbare sipas dispozitave të zbatuara ligjore, nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1633/23, me datë 15.02.2024

Gjyqtari  
Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.